



**PROGRAM ORIENTUES PËR PROVIMIN
E MATURËS SHETËRORE PROFESIONALE 2015**

TEORIA PROFESIONALE E INTEGRUAR:

**PROFILI MËSIMOR “MBËSHTETJE E PËRDORUESVE TË
TEKNOLOGJISË SË INFORMACIONIT DHE
KOMUNIKIMIT (TIK)”**

(DREJTIMI MËSIMOR “TIK”)

Janar, 2015

1. Udhëzime të përgjithshme

Ky program orientues ndihmon në përgatitjen e nxënësve të profilit “**Mbështetje e përdoruesve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)**”, me strukturë 2+2, për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale 2015. Ai synon orientimin e përgatitjes së nxënësve nëpërmjet përqendrimit në njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të lëndëve teorike profesionale. Njëherazi, ndihmon edhe në verifikimin paraprak të përgatitjes përfundimtare të nxënësve sepse mundëson zhvillimin e testeve përmbledhëse. Programi orientues për provimin e “Teorisë profesionale të integruar” bazohet në:

- programin orientues për Provimet Përfundimtare në drejtimin “TIK”, Niveli I;
- programet e lëndëve teorike profesionale të profilit “Mbështetje e përdoruesve të Teknologjisë së Informacionit dhe Komunikimit (TIK)”, Niveli III (klasa e 12-të dhe 13-të);
- Udhëzimin e përbashkët të MAS dhe MMSR nr. 2, datë 06.02.2015 “Për zhvillimin e provimeve të Maturës Shtetërore Profesionale 2015 në Republikën e Shqipërisë”.
- Rregulloren e Maturës Shtetërore 2015 në Republikën e Shqipërisë, miratuar me Urdhërin e Ministrit nr.61, datë 10.02.2015.

Në të përfshihen njohuritë dhe aftësitë më të rëndësishme të këtyre programeve dhe që janë në themel të formimit teorik profesional të nxënësit.

2. Udhëzime për zbatimin e programit

Ky program duhet shqyrtuar me kujdes sepse evidenton dhe përforcon njohuritë teorike, por dhe aftësitë e nxënësve për aplikimin e njohurive në situata të njohura e të reja, analizën dhe vlerësimin e këtyre situatave. Specialistët e përfshirë në hartimin e bankës së pyetjeve dhe tezës së provimit të kësaj lënde, nuk duhet të përfshijnë për vlerësim tema mësimore që nuk janë parashikuar në këtë program. Përgatitja e nxënësve për provim të bëhet në mënyrë të vazhdueshme dhe duke përdorur një larmi metodash dhe mjetesh.

Gjatë punës për përgatitjen e nxënësve për provimin me zgjedhje të detyruar “Teori profesionale e integruar” të Maturës Shtetërore Profesionale, është e rëndësishme që herë pas here mësuesi të zhvillojë teste të nxënësve të tij, me teste që mund t’i hartojë vetë duke u bazuar në modelet e mëparshme të testeve të Maturës Shtetërore për teorinë profesionale.

Testi për profilin mësimor “**Mbështetje e përdoruesve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)**” do të ndërtohet në mënyrë të tillë ku të jenë të përfshira të tri nivelet e vështirësisë: niveli bazë, niveli mesatar dhe niveli i lartë. Njëkohësisht, edhe shpërndarja e pikëve në test do të jetë në varësi të përqindjeve që zë çdo nivel. Gjatë

hartimit të njësive të testit duhet të mbahen parasysh synimet e përgjithshme, në skeletkurrikulat përkatëse, të temave të përzgjedhura në këtë program.

Nxënësit duhet të kenë parasysh se lënda, e cila ka peshën më të madhe në këtë program orientues të Maturës Shtetërore Profesionale, në test do të përfaqësohet nga një numër më i madh pyetjesh.

3. Lëndët dhe temat përkatëse

Në programin orientues të provimit të **“Teorisë profesionale të integruar”** në kuadrin e provimit me zgjedhje të detyruar **“Teori profesionale e integruar”**, të Maturës Shtetërore Profesionale, për profilin mësimor **“Mbështetje e përdoruesve të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit (TIK)”**, do të përfshihen programet e lëndëve profesionale të mëposhtëme:

1. Bazat e elektroteknikës, kl. 10.
2. Bazat e elektronikës, kl. 10.
3. Bazat e kompjuterit, kl. 10.
4. Sistemet e shfrytëzimit, kl. 10 dhe kl.11.
5. Programet aplikative, kl. 10.
6. Rrjetet kompjuterike, kl. 11.
7. Bazat e sipërmarrjes, kl. 12 dhe kl. 13.
8. Arkitekturë kompjuteri dhe rrjetesh, kl. 12.
9. Algoritmikë dhe programim, kl. 12.
10. Sisteme multimediale, kl. 12 dhe kl. 13.
11. Administrim sistemesh shfrytëzimi, kl. 13.
12. Baza të dhënash, kl. 13.
13. Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl. 13.

Tabela 1: Lëndët dhe peshat përkatëse në programin orientues

Nr	Lënda	Vëllimi i orëve për çdo lëndë	Peshat në %
1	Bazat e elektroteknikës	19	6
2	Bazat e elektronikës	20	6
3	Bazat e kompjuterit	29	9
4	Sistemet e shfrytëzimit	21	6
5	Programet aplikative	6	2
6	Rrjetet kompjuterike	47	15
7	Bazat e sipërmarrjes	19	6

8	Arkitekturë kompjuteri dhe rrjetesh	40	13
9	Algoritmikë dhe programim	32	10
10	Sisteme multimediale	16	5
11	Administrim sistemesh shfrytëzimi	33	10
12	Baza të dhënash	22	7
13	Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm	14	5
	TOTALI	318	100%

Temat sipas lëndëve janë:

- a) **“Bazat e elektroteknikës”, kl.10: (19 orë)**
- Madhësitë elektrike bazë dhe lidhja midis tyre (ligji i Ohm-it) 7 orë
 - Qarku në seri me rezistenca dhe ligji i II i Kirkofit 6 orë
 - Qarku në paralel me rezistenca dhe ligji I i Kirkofit 6 orë
- b) **“Bazat e elektronikës”, kl.10: (20 orë)**
- Materialet gjysëmpërcjellës, tipet dhe përdorimet e tyre 4 orë
 - Diodat gjysëmpërcjellëse, llojet, përdorimi dhe karakteristikat 5 orë
 - Tranzistorët, llojet, përdorimi dhe karakteristikat 8 orë
 - Përforcuesit dhe parametrat e tyre 3 orë
- c) **“Bazat e kompjuterit”, kl.10: (29 orë)**
- Parimet bazë të punës së një kompjuteri (*Hardware – Software*) 4 orë
 - Parimet bazë të lëvizjes së informacionit, drajverat 3 orë
 - Njësia qendrore dhe pjesët përbërëse 3 orë
 - Periferikët dhe pajisjet hyrëse dhe dalje të informacionit (mausi, tastiera, printeri, skaneri, kamera, mikrofoni, modemi, etj.) 4 orë
 - Memorja e përkohëshme (*RAM*) dhe e përhershme (*ROM*), skemat dhe njësiti matëse 3 orë
 - Pajisja e ruajtjes së informacionit (*Hard Disk*), skema dhe njësiti matëse 3 orë
 - *Motherboard*-i, skema e thjeshtuar, elementët kryesorë 4 orë
 - Procesori, gjeneratat, llojet dhe njësiti matëse 3 orë
 - Portat dhe kabllot lidhëse 2 orë
- d) **“Sistemet e shfrytëzimit”, kl.10 dhe kl.11: (21 orë)**
- Hartimi, funksionet dhe llojet e programeve të kompjuterit 2 orë
 - Programet e sistemit dhe programet aplikativë, dallimet midis tyre 2 orë
 - Sistemet e shfrytëzimit që njihen sot, historia e tyre. Dallimet dhe funksionet e secilit 4 orë
 - Ndërfaqësitë e sistemeve të shfrytëzimit, dallimi midis tyre 2 orë
 - *Desktop*-i i *Windows*-it. Elementët kryesorë, funksionet e ikonave 2 orë

- Sistemet *Linux-Unix* dhe ndërtimi i tyre 2 orë
 - Konfigurimi i rrjetit dhe lidhjes në Internet 3 orë
 - Përdorimi i komandave bazë në *Linux* dhe *DOS* 4 orë
- e) “**Programet aplikative**”, kl.10: (6 orë)
- Lundrimi në *Internet*, motorët e kërkimit. Faqet *Yahoo*, *Google*, etj. 4 orë
 - Teknikat e kërkimit në *Search engine* dhe sintaksat e tyre 2 orë
- f) “**Rrjetet kompjuterike**”, kl.11: (47 orë)
- Hyrje. Llojet e rrjeteve kompjuterike 2 orë
 - Topologjitë (*Bus*, *Ring*, *Star*, *Mix*) 4 orë
 - Modelet e rrjeteve (*OSI*, *DoD*, *TCP*) 4 orë
 - Mediat dhe teknikat e transmetimit me kabëll (*LAN* dhe *WAN*), ndërtimi, kategoritë, specifikimet dhe fushat e përdorimit 6 orë
 - Përbërësit aktivë të rrjetit, nyjet e rrjetit (*kabllot*, *hub*, *switch*, *repeater*, *bridge*, *router*, *gateway*, *network adapter*) 6 orë
 - Protokollat e sotme të komunikimit, detyrat dhe shërbimet 4 orë
 - Procedurat e aksesimit të *LAN*-it, teknologjia *Ethernet* 4 orë
 - Bashkësia e protokolleve *TCP/IP* dhe detyrat 3 orë
 - Funkzioni dhe ndërtimi i *TCP*-së dhe *UDP*-së 4 orë
 - Protokollat e aplikacioneve (*http*, *ftp*, *smtp*, *pop*, *imap*, etj.) 6 orë
 - Lidhjet në *Internet* (*Modem*, *ISDN*, *DSL*, *ADSL* etj.) 4 orë
- g) “**Bazat e sipërmarrjes**”, kl.12 dhe kl.13: (19 orë)
- Tregu dhe sjellja konsumatore 5 orë
 - Legjislacioni i punës 5 orë
 - Menaxhimi i informacionit 4 orë
 - Menaxhimi i marketingut 5 orë
- h) “**Arkitekturë kompjuteri dhe rrjetesh**”, kl.12: (40 orë)
- Motherboard-i 5 orë
 - Procesorët 4 orë
 - Memoriet 3 orë
 - Hard disqet dhe pajisjet ruajtëse 3 orë
 - Llojet, topologjitë dhe modelet e rrjetave kompjuterike 5 orë
 - Modeli *OSI* dhe funksionet e shtresave 3 orë
 - Pajisjet e rrjetit dhe protokollat 7 orë
 - Konfigurimi klient-server 3 orë
 - Skemat e adresimit në rrjet 4 orë
 - Interneti dhe *WWW* 3 orë
- i) “**Algoritmikë dhe programim**”, kl.12: (32 orë)

- Pseudokodi, bllokskemat dhe simbolika e tyre 2 orë
- Shprehja e algoritmeve nëpërmjet bllokskemave 2 orë
- Prezantim me gjuhën C 2 orë
- Tipet e të dhënave 2 orë
- Emrat dhe deklarimi i variablave 2 orë
- Operatorët aritmetikë 2 orë
- Operatorët e krahasimit 2 orë
- Operatorët logjikë 2 orë
- Vlerësimi i shprehjeve dhe prioriteti i operatorëve 2 orë
- Degëzimi i kodit (IF Else) 2 orë
- Cikli for 4 orë
- Cikli while 4 orë
- Cikli do..while 4 orë

j) **“Sisteme multimediale”**, kl.12 dhe kl.13: **(16 orë)**

- Koncepte bazë të tingullit 2 orë
- Formatet audio 2 orë
- Koncepte bazë të imazheve 2 orë
- Imazhet matricore 2 orë
- Imazhet vektoriale 2 orë
- Formatet e skedarëve grafike 2 orë
- Formatet e video-s 2 orë
- Kodimi i videos 2 orë

k) **“Administrim sistemesh shfrytëzimi”**, kl.13: **(33 orë)**

- Sistemi *DNS* (Domain name system) 3 orë
- Krijimi i një domain-i 3 orë
- Regjistrimi i posteve të punës 3 orë
- Shërbimet në Active Directory 4 orë
- Administrimi i objekteve të Active Directory 4 orë
- Administrimi i grupeve 3 orë
- Menaxhimi i attributeve të burimeve të përbashkëta 4 orë
- Administrimi i aksesit të përdoruesve (*DFS*) 3 orë
- Administrimi i profilit të përdoruesve 3 orë
- Administrimi i direktivave të grupit 3 orë

l) **“Baza të dhënash”**, kl.13: **(22 orë)**

- Hyrje në bazat e të dhënave (shtresat) 2 orë
- Modelet e të dhënave (modeli konceptual, llogjik, fizik) 2 orë
- Bazat e të dhënave relacionale 2 orë
- Ndërtimi i skemës logjike të bazës së të dhënave 2 orë
- Komanda *SELECT* 2 orë

- Klauzola *WHERE* 2 orë
 - Operatorët e krahasimit dhe lidhëzat logjike 2 orë
 - Llogaritja e shprehjeve dhe përparësia e operatorëve 2 orë
 - Query mbi disa tabela; *JOIN (EQUI, INNER, OUTER, CROSS Join)* 6 orë
- m) **Mjedisi dhe zhvillimi i qëndrueshëm, kl.13:** (14 orë)
- Burimet kryesore të mjedisit dhe degradimi mjedisor 3 orë
 - Ndikimi i veprimtarisë së njeriut në mjedis 3 orë
 - Zhvillimet demografike dhe mjedisi 4 orë
 - Shoqëria e konsumit dhe mbetjet 4 orë